

Udhëzuesi i RAN EDU rreth programeve të trajnimit

“Efektshmëria dhe konfidenca e mësuesve
dhe stafit tjetër pedagogjik”

Ky dokument është shkruar nga **Steven Lenos dhe Marjolein Keltjens**, nga RAN Centre of Excellence. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e RAN Centre of Excellence, të Komisionit Evropian apo të ndonjë institucioni ose pjesëmarrësi tjetër të grupit të punës të RAN EDU.

Falënderimet

Një falënderim i veçantë shkon për drejtuesit e Grupit të Punës të RAN EDU, Karin Heremans (BE) dhe Michèle Hassen (FR) në kontributin e dhënë për këtë udhëzues dhe për drejtimin e sesionit të Grupit të Punës të RAN EDU në Helsinki (1-2 mars 2017).

Ky udhëzues është hartuar në bashkëpunim me pjesëmarrësit e takimit në Helsinki: Patrick Wolf (AT), Bruno Sedran (BE), Igor Đorđević (HR), Jesper Holme Hansen (DK), Szilvia Kalman (COM), Jan Löfstrom (FI), Aija Korteesmaa (FI), Satu Elo (FI), Maria Edel (FI), Leena Malkki (FI), Bram Edel (FI), Daniel Sallamaa (FI), Pierre Carrolaggi (FR), Karen Prévost-Sorbe (FR), Manfred Diekenbrock (DE), Mark Medebach (DE), Alexandra Vassiliou (EL), Veszna Wessenauer (HU), Mary Ryan (IE), Igor Kitayev (IT), Jennie Holck-Clausen (NO), Sylvia Ondrisova (SK), Mieke Bernaerts (NL), Fleur Nollet (NL), Stijn Sieckelinck (NL), Rob Hommen (NL), Abigail Clay (UK), Alan Fraser (UK), Geraint Evans (UK), Jon Nicholas (UK) and Ted Huddleston (UK).

Hyrje

Le të përballemi me të vërtetën. Është fakt se shkollat dhe personeli pedagogjik po përballen me radikalizimin dhe çështje që lidhen me të ose që çojnë në radikalizim. Shumica e fëmijëve e gjejnë veten në debate të nxehta me nxënës që shprehin opinione ekstreme. Duke zhvilluar biseda sfiduese, ata mund të përpiqen të diskutojnë tema delikate dhe të përballen me sjelljet kundërshtuese të nxënësve në klasë. Ose, ndërsa një prej nxënësve bëhet gjithnjë e më i tërhequr e më i distancuar, ata mund të jenë të pasigurt se cilën linjë veprimi duhet të ndjekin. Disa shkolla kanë pasur humbje të nxënësve që largohen drejt të ashtuquajturit Shteti Islamik. Shkollat e ndiejnë urgjencën dhe duhet të vepronë dhe duan të luajnë një rol. Kjo është shprehur qartë në Manifestin për Arsimin të Radicalisation Awareness Network (RAN)¹.

Megjithatë, shkollat dhe stafi pedagogjik duhet të jenë të pajisur për ta bërë këtë siç duhet. Siç është shpjeguar në raportin e RAN “Roli i arsimit në parandalimin e radikalizimit”², mësuesit janë të mirë-pozicionuar për të nxitur vlerat demokratike në klasë. Nëse kjo nuk mund të bëhet në shkollë, shoqërisë i shkaktohen probleme.

Nën dritën e polarizimit në rritje dhe fenomenit “të ri” si ekstremizmi me motivim fetar, shumë mësues shprehin shqetësime rreth mungesës së njohurive, aftësive dhe konfidencës për të ofruar një përgjigje të përshtatshme ndaj kësaj sfide. Siç u diskutua në takimimin e RAN “Drejtuesit e shkollave dhe parandalimi i radikalizimit”³, drejtuesit e shkollave kanë përgjegjësinë e krijimit të ekuilibrit në krijimin e mjedisit të duhur për këto biseda të vështira. Nga njëra anë, ata duan që nxënësit të kenë hapësirën për të shprehur lirshëm ndjenjat e tyre dhe ndonjëherë të eksplorojnë pikëpamje kundërshtuese ose jodemokratike. Nga ana tjetër, ata duhet të menaxhojnë reagimet që mund të jenë negative ose madje edhe plot zemërim nga prindërit, kolegët, shtypi dhe politikanët. Drejtorëve të shkollave gjithashtu u kërkohet të mbrojnë sigurinë fizike dhe mendore të të gjithë nxënësve dhe stafit pedagogjik.

Nëse mësuesit, drejtorët dhe stafi tjetër pedagogjik duhet të përmbushin rolet e tyre dhe të përgatiten dhe fuqizohen, trajnimi është me rëndësi kyçe. Programet e trajnimit rreth temës së radikalizimit po rriten në mënyrë eksponenciale: ato shfaqen në forma të ndryshme dhe cilësia e tyre dryshon. Pra, cilat lloje trajnimi janë të disponueshme? Si të zgjedhim? Dhe në cilin të investoni kohë dhe para? Grupi i punës i RAN EDU i diskutoi këto tema në takimimin e vet në Helsinki (Finlandë) në datat 1 dhe 2 mars 2017, dhe dha një kontribut të përbashkët për këtë udhëzues rreth programeve të trajnimit.

¹ Shikoni https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/docs/manifesto-for-education-empowering-educators-and-schools_en.pdf online.
(Radicalisation Awareness Network. (2016). RAN PREVENT: Manifesti për arsimin – Fuqizimi i mësuesve dhe shkollave)

² Shikoni https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/role_education_preventing_radicalisation_12122016_en.pdf online.
(Radicalisation Awareness Network. (2016). Raporti i RAN: “Roli i arsimit në parandalimin e radikalizimit”)

³ Shikoni https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-edu/docs/ex_post_paper_ran_edu_antwerp_19-20_04_2016_en.pdf online.
(Radicalisation Awareness Network. (2016). Dokumenti aktual i RAN EDU: “Drejtuesit e shkollave dhe parandalimi i radikalizimit: krijimi i kushteve për një mjedis të sigurt dhe demokratik”)

Pikëpamjet e RAN EDU rreth radikalizimit dhe radikalëve

Terma të tilla si radikal, radikalizim, ide ekstreme dhe ekstremist, kanë tendencën të shkaktojnë shumë konfuzion dhe ndonjëherë edhe debat të nxehtë. Ky dokument është një përpjekje për të prezantuar një gjuhë që përputhet me atë të RAN **dhe gjithashtu** u shërben mësuesve që punojnë me fëmijët e rritur.

Një pjesë e rëndësishme e mësimdhënies është që nxënësit të pajisjen për t'u përfshirë te zhvillimet në shoqëri. Fëmijët e rritur që po drejtohen drejt moshës madhore dhe qytetarisë do të sfidojnë ide, do të testojnë kufijtë dhe do të shprehin opinionet e tyre, ndonjëherë konfrontuese. Shkollat duhet të ofrojnë një vend të sigurt ku mund të diskutohen padrejtësitë dhe shqetësimet e perceptuara dhe ku mund të shprehet trazimi ose zemërimi. Në një mjedis të tillë, një sasi e shëndetshme radikalizimi nuk përbën arsye për shqetësim. Radikalët nxisin ndryshimet dhe luftojnë për drejtësi sociale. Pa radikalët që sfidojnë sistemin dhe statuskuonë, sot nuk do të kishte të drejta për gratë, të drejta themelore dhe politika mjedisore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen mjedisore. Shkollat duhet të jenë vendi ku mund të shprehen idetë radikale madje edhe opinionet ekstreme. Por, kjo duhet të zhvillohet në një mjedis të sigurt pedagogjik, e drejtuar nga mësues të trajnuar. Kjo lejon që idetë radikale të konfrontohen dhe të sfidohen, dhe radikalët e rinj të drejtohen larg një shtegu që mund të çojë në ekstremizëm dhe madje edhe dhunë.

Prandaj, radikalët dhe idetë radikale në vetvete nuk janë shqetësim. Ekziston një problem real, megjithatë, me radikalizimin që çon në shkelje të të drejtave të njeriut te të tjerëve, krime urrej-tjeje ose madje dhunë dhe terror ekstremist. Kjo formë radikalizimi do të rezultojë në fëmijë të rritur që kërcënojnë shoqërinë dhe vënë të ardhmen e tyre në rrezik.

Çfarë është ky udhëzues?

Ky udhëzues nuk është inventar i të gjitha programeve ekzistuese të trajnimit. Ai prezanton një kuadër për diskutimin e opsioneve të ndryshme për programet dhe modulet e trajnimit në një program trajnimi ose program trajnues për mësuesit.

Përqasja jonë ndaj çështjes së radikalizimit në shkolla u jep mësuesve një rol në mbrojtjen e nxënësve kundër shfrytëzimit nga rekrutuesit dhe radikalizuesit e grupeve ekstremiste. Mësuesit janë edukues dhe instruktues të një hapësire të sigurt që mund të nxisë qytetarinë, mendimin kritik dhe ndërtimin e identitetit. Kjo është vija më e mirë e mbrojtjes kundër zhvillimeve të ekstremizmit që kërcënojnë shtetin ligjor dhe të drejtat themelore në Evropë. Për mësuesit dhe shkollat e gatshme që investojnë kohë të vlefshme dhe para në trajnim, ne shpresojmë që ky udhëzues do t'i ndihmojë ata të qartësojnë idetë se çfarë u nevojitet, çfarë u mungon dhe çfarë duhet të synojnë.

Zhvilluesit e kurseve të trajnimit dhe ata që janë përgjegjës për politikën e trajnimit ose zhvillimin profesional të mësuesve, mund të përdorin **taksonominë** për të përcaktuar nëse po mbulojnë kompetencat.

Për të dyja, ne këshillojmë shumë që të fokusohet jo vetëm te radikalizimi apo madje terrorizmi, por edhe te rolet profesionale, kontributet dhe kufizimet e stafit në pritje të trajnimit. Në fund, objektivi është të rritet ndërgjegjësimi dhe të bëhet **“transferimi”**: të hartohet një plan trajnimi dhe të krijohet një mjedis i cili lejon që trajnimi të aplikohet çdo ditë në punë.

1. Llojet e ndryshme të trajnimeve

“Trajnimi i shkollave për parandalimin e radikalizimit dhe luftimin e ekstremizmit” mund të interpretohet lehtë si “shkollat mësojnë si të dallohen shenjat e radikalizimit” ose “mësuesit udhëzohen të promovojnë demokracinë”. Diskutimet e RAN EDU treguan se ndërkohë që këto lloje programesh trajnimi ekzistojnë, nevojitet më shumë punë dhe trajnim për të fuqizuar shkollat që të përmbushin potencialin e tyre. Një përmbledhje e programeve të trajnimit nëpër shtete të ndryshme evropiane zbuloi tre lloje programesh trajnimi:

- A. ato që ofrojnë trajnim themelor për mësues të fuqizuar dhe rezistentë;
- B. ato që mbrojnë dhe krijojnë shkolla të sigurta dhe demokratike;
- C. ato që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive për t’u përballur me sfidat aktuale.

Brenda secilës prej këtyre tre grupeve të programeve të trajnimit, mund të identifikohet një numër programesh trajnimi, që ndryshojnë në objektivat mësimore. Këto grupe mund të përdoren për të strukturuar diskutimin dhe vendimmarrjen rreth trajnimit për shkollat. Ne jemi të ndërgjegjshëm se një program trajnimi shpesh mund të trajtojë njëkohësisht më shumë se një objektiv mësimor, dhe se ka në fakt kombinime të më shumë se një programi.

Ekzistojnë tema të ndryshme dhe programe trajnimi të lidhura me to.

- A. Trajnim themelor për mësues të fuqizuar dhe rezistentë
 - 1. mësues të fuqizuar dhe rezistentë
 - 2. mësues si instruktues për debatet dhe bisedat në grup
- B. Mbrojtja dhe krijimi i shkollave të sigurta dhe demokratike
 - 3. ndërgjegjësimi dhe kuptimi i rrezikut të radikalizimit dhe rekrutimit
 - 4. si ta kthejmë shkollën në një mikrokozmos të sigurt dhe demokratik të shoqërisë?
 - 5. siguria fizike
- C. Aftësitë për t’u përballur me sfidat e sotme
 - 6. aftësitë në njohjen e medias sociale, lajmeve të rreme dhe teorive konspirative
 - 7. trajnimi depolarizues, tensionet në shoqëri, investimi në paqe dhe stabilitet social
 - 8. trajtimi i kulturave, fesë, ideologjisë dhe identitetit.

A. Trajnim themelor për mësues të fuqizuar dhe rezistentë

1. Mësues të fuqizuar dhe rezistentë

Pse është me rëndësi kjo për shkollat?

Nën presionin e prindërve, nxënësve dhe komunitetit, mësuesit duhet të ndihen konfidentë dhe të fuqizuar për të trajtuar me sukses situatat me të cilat përballen. Natyrisht, ata kanë anësitë e tyre personale në rolin profesional dhe ndihen veçanërisht të sfiduar nëse konfrontohen në çështje që i ngacmojnë ata personalisht ose nga pikëpamjet që janë në kundërshtim me të tyre.

Në dritën e këtyre sfidave, mësuesit duhet të dinë kufizimet e tyre, dhe të jenë të vetë-ndërgjegjshëm dhe vetë-reflektues. Gjithashtu, ata duhet të ndërtojnë një raport me nxënësit: nxënësit mësojnë më shumë nga mënyra se si mësohen sesa nga ajo që u mësohet. Qëndrimi është më i rëndësishëm se teknika dhe mësuesit mund ta kthejnë karakterin në letër në karakter në praktikë.

Cili është objektivi i këtij lloji trajnimi?

Ky lloj trajnimi përcakton objektivat e mëposhtme për mësuesit.

- Të rritet ndërgjegjësimi i mësuesve për vizionin e tyre të brendshëm, vlerat dhe pikat e forta. Ata duhet të kuptojnë pritshmëritë dhe kompetencat që kërkohen për rolin e tyre.
- Të përmirësohen aftësitë interaktive, komunikimi, zgjidhja e problemeve dhe mendimi kritik.
- Të zhvillohen aftësitë për moderimin e diskutimeve.
- Të mësojnë se si të përdorin fuqinë me efektshmëri dhe saktë.
- Të mësojnë gjatë procesit dhe nga kolegët, dhe të reflektojnë, vëzhgojnë, diskutojnë dhe mbështesin rritjen profesionale të njëri-tjetrit.
- Të ndihen në gjendje t'i kërkojnë ekipit mbështetje.
- Të krijojnë shkolla të sigurt dhe demokratike duke diskutuar probleme të botës reale në klasë.
- Të mësojnë se si të jenë vetë-kritikë dhe vetë-reflektivë: "Si duhet të trajtoj situata të ndryshme dhe sfiduese në klasë?" Të reflektojnë mbi efektet negative të etiketimit. Të ndjekin ciklin »planifiko, bëj, kontrollo dhe vepro".
- Të ndihen konfidentë, komodë dhe të relaksuar.
- Të pranojnë se ata nuk i kanë të gjitha përgjigjet.
- Të mësojnë se si të ulin gjakrat në një situatë.
- Të mësojnë se si të krijojnë një atmosferë përfshirjeje.
- Të bëhen mësues profesionistë që janë të ndërgjegjshëm për anësitë e tyre personale dhe të jenë në gjendje ta kontrollojnë atë anësi.

Kush është audiencia e synuar?

Audiencia e synuar përcaktohet si:

- të gjitha shkollat dhe të gjithë mësuesit.

Mesazhet kyçe dhe rekomandimet

- Profesionalizmi duhet të karakterizojë karakterin e të gjithë shkollës, jo vetëm të klasës. Prandaj, mbështetja nga drejtorët është e rëndësishme.
- Të krijohet një kuadër për shkollat, në mënyrë që shkollat ta hartojnë trajnimin sipas nevojave të tyre.
- Kthimi në një mësues të fuqizuar dhe rezistent duhet të jetë një proces zhvillimi dhe reflektimi i vazhdueshëm.
- Trajnimi duhet të ofrojë ndihmë praktike për mësuesit.
- Mësuesit do të mësojnë dhe do të rriten, dështimi lejohet si pjesë e procesit të mësimi.
- Ndërgjegjësohuni rreth ndryshimeve/sfidave të mundshme gjatë trajnimit të mësuesve pa përvojë dhe me përvojë. Të parët fillimisht nuk do të kenë shumë për të ndërtuar, ndërsa të dytët mund të jenë rezistentë ndaj ndryshimeve.
- Trajnimi nuk duhet të trajtojë direkt radikalizimin dhe ekstremizmin. Megjithatë, kur lindin çështjet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, është e rëndësishme që mësuesit të jenë të ndërgjegjshëm për kontekstin: Kush e përkufizon se çfarë është “radikale” apo “ekstreme”?
- Duhet të theksohet ndryshimi mes njohurive dhe kompetencave emocionale. Të parat kanë lidhje me informacionin (ku ta marrim, si ta transmetojmë), ndërsa të dytat lidhen me mënyrën e raportit tim (me veten, me të tjerët, me një grup, me komunitetin).
- Objektivi është të parandalohet dhuna, dhe jo të ndrydhet krijimtaria apo mendimi radikal.

Shembuj

- mësuesit e fuqizuar (të përshkruar në RAN Collection)
- Mendimi i kompleksitetit integrativ (IC) (i përshkruar në RAN Collection)
- programimi neuro-linguistik (NLP) (i përshkruar në RAN Collection)
- mësimi i çështjeve kontroverse (i përshkruar në RAN Collection)
- shkollat ku kjo ndodh tashmë mund të shërbejnë si shembuj të praktikave të mira.

2. Mësuesi si instruktues për debatet dhe bisedat në grup

Pse është me rëndësi kjo për shkollat?

Roli i mësuesve ka ndryshuar shumë. Nuk do të ishte e tepërt të thuhej se mësuesit bëjnë më shumë sesa ndajnë njohuri me nxënësit në stilin frontal: roli i tyre i ri është të moderojnë diskutimet ose madje edhe debatet e nxehta në situata të jetës reale, ngjarje lajmesh apo jetën personale të nxënësve. Këto biseda mund të nisen nga mësuesi, ose mund të zhvillohen në mënyrë spontane. Kjo kërkon që mësuesit të ndryshojnë rolet dhe përqasjet: kryetar neutral, “avokat i djallit” ose kujtues i vijës zyrtare, siç përshkruhet në paketën e trajnimit të mësuesve “Mësimi i çështjeve kontroverse”⁴. Ky rol i ri që luajnë mësuesit për nxënësit e tyre, është jo vetëm i rëndësishëm për parandalimin e radikalizimit dhe mbrojtjen dhe ndërtimin e rezistencës. Ai është një ndryshim i përgjithshëm që e kërkon momentet sfiduese.

⁴ Shikoni <http://pjp-eu.coe.int/en/web/charter-edc-hre-pilot-projects/teaching-controversial-issues-developing-effective-training-for-teachers-and-school-leaders> online. (Këshilli i Evropës. (2016). Bashkëjetesa me kontroversen. Mësimi i çështjeve kontroverse përmes edukimit për qytetari demokratike dhe të drejtat e njeriut (EDC/HRE): Paketa e trajnimit për mësuesit (Strasbourg: Publikimet e Këshillit të Evropës))

Bisedat, dëgjimi dhe veçanërisht dialogu janë rrugë përmes të cilave mësohet. Individëve u jepet e drejta e fjalës: ata e ndiejnë se janë të përfshirë dhe besojnë se opinionet e tyre merren në konsideratë. Nxënësit duhet të mësojnë se si të funksionojnë në një demokraci dhe të kuptojnë se kjo kërkon (që të dëgjohen) opinione të ndryshme.

Cili është objektivi i këtij lloji trajnimi?

Ky lloj trajnimi përcakton objektivat e mëposhtme për mësuesit.

- Të dinë cilat role mund të përdorin në diskutime (p.sh. moderimin ose debatin).
- Të jenë në gjendje të ndihen konfidentë për aftësitë e tyre kur paraqiten çështje kontroverse.
- Të provojnë të vazhdojnë bisedat, edhe kur kjo është sfiduese, dhe të zgjerojnë pikëpamjet e nxënësve duke i inkurajuar ata të kuptojnë botëkuptime të ndryshme.
- T'u tregojnë nxënësve se ekziston më shumë se një ide "e mirë".
- T'i shohin nxënësit si individë, jo vetëm si pjesëtarë të një grupi specifik bazuar në identitetin e tyre të perceptuar gjinor, racial, etnik, seksual dhe klasor. Pyetje të tilla si "Çfarë mendon për këtë si grua/si mysliman" nuk janë të dobishme në këtë aspekt.
- Të krijohet një mjedis ku ata mund të familjarizojnë nxënësit e tyre me argumente dhe perspektiva të ndryshme.
- Janë të ndërgjegjshëm se shpesh mendojnë se dinë "përgjigjen e duhur" dhe se nxënësit e dinë këtë "axhendë të mësuesit".

Kush është audienca e synuar?

Audienca e synuar përcaktohet si:

- mësuesit.

Mesazhet kyçe dhe rekomandimet

- Mësuesve duhet t'u lejojehet të mësojnë në fushën e tyre të specializimit: ata kanë më shumë mundësi të lidhen me nxënësit e tyre dhe të përfshihen në dialog. Çdo mësues ka nevojë për aftësi në komunikim dhe dialog, gjë që mund të sjellin ndryshim në metodat e tjera të debatit.
- Të trajnohen më shumë mësues nga shtetet nga vijnë nxënësit dhe me të cilët mund të identifikohen, në mënyrë që mund të shërbejnë si shembuj.
- Ndërkohë që mësuesit mund të ndihen nën presion për të dhënë gjithmonë një përgjigje, kjo nuk është realiste. Është më mirë që të jeni të hapur dhe të shpjegoni se dikush nuk mund të jetë ekspert në të gjitha fushat.
- Mësuesit duhet gjithmonë të kenë një përfundim/mbyllje specifike për mësimet e tyre: nevojitet planifikim i kujdesshëm.
- Nëse një nxënës përdor fakte të rreme, të pavërteta për të mbrojtur pozicionin e vet, nuk mund t'i bindni duke u dhënë informacione të tjera. Kur nxënësit mendojnë se nuk u dëgjohet fjala, mësuesit duhet të krijojnë një hapësirë për t'u ankuar; ndonjëherë nxënësit do të vënë në dyshim informacionin që kanë, pasi të keni dëgjuar ankesën e tyre.

Shembuj

- Mësimi i çështjeve kontroverse.

B. Mbrojtja dhe krijimi i shkollave të sigurta dhe demokratike

3. Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i rrezikut të radikalizimit dhe rekrutimit

Pse është me rëndësi kjo për shkollat?

Shkollat janë në vijën e frontit dhe janë të parat që identifikojnë rreziqet e radikalizimit. Mësuesit duhet të sigurohen që përgjigjet e tyre të jenë të ekuilibruara dhe proporcionale (jo shumë, jo pak dhe të jepen në momentin e duhur). Ekziston rreziku i demonizimit dhe i kriminalizimit të subjektit.

Biseda profesionale është thelbësore: mësuesit duhet të kuptojnë se diskutimi i radikalizimit me kolegët dhe profesionistët e tjerë është gjithashtu i rëndësishëm. Shikojeni radikalizimin dhe rekrutimin si rrezik që duhet monitoruar.

Cili është objektivi i këtij lloji trajnimi?

Ky lloj trajnimi përcakton objektivat e mëposhtme për mësuesit.

- Të kuptohet procesi i radikalizimit, motivet dhe faktorët e radikalizimit, si dhe profilet dhe proceset e radikalizimit. Ata duhet të jenë në gjendje të dallojnë sinjalet e mundshme se kjo po ndodh.
- Shkatërrimi i miteve: demaskimi i miteve rreth radikalizimit.
- Të arrihet një kuptim më i mirë i termit “radikalizim”. Të përkufizohet se çfarë është dhe çfarë nuk është (!) radikalizimi, duke u siguruar njëkohësisht që përkufizimet të jenë të sakta.
- Të kontekstualizohen çështjet lokale brenda kuadrit të fenomenit global të radikalizimit.
- Të kuptohet rreziku i radikalizimit dhe rekrutimit dhe roli i tyre në parandalimin e tij.
- Të jenë fuqizuar me njohuri dhe konfidencë.
- Të jenë të ndërgjegjshëm për shenjat dhe të dinë se cilët hapa të ndërmarrin.
- Të kuptojnë ndryshimin mes opinionëve personale dhe vlerave të përbashkëta të pranuar në shkollë dhe ndikimin e mundshëm të anësive personale.
- Të jenë të ndërgjegjshëm për rolin dhe mundësitë e tyre në mbrojtjen e parimeve.
- Të jenë të familjarizuar me procedurat dhe protokollet.

Kush është audienca e synuar?

- Mësuesit, drejtorët e shkollave.
- Grupe të përziera me profesionistë të tjerë, siç janë profesionistët e kujdesit dhe prindërit.
- Të gjithë të rriturit në shkollë (“komuniteti i arsimit”).
- Stafi aktual “i caktuar” (stafi i trajnuar me përgjegjësitë shtesë dhe trajnimin e kërkuar) — kjo do të përfshijë trajnimin multi-agjenci.
- I gjithë stafi, si pjesë e trajnimit aktual të mbrojtjes – duhet të përfshihen protokollet e ndarjes së informacionit dhe bisedat profesionale.

Mesazhet kyçe dhe rekomandimet

- Të përdoren studime rasti nga jeta reale, të anonimizuara nëse nevojitet:
 - ja si i kemi identifikuar shenjat;
 - cila është prejardhja e personit të radikalizuar?
 - ja se çfarë bëme;
 - kjo ishte ajo që ndodhi;
 - çfarë duhet të kishim bërë ndryshe?
- Sigurohuni që mësuesit të punojnë me studime rastesh të dokumentuara mirë, dhe nuk marrin informacion vetëm nga media.
- Mësuesit kanë nevojë për këtë trajnim përpara se të fillojnë të përfshihen me fëmijët mbi këtë temë.
- Mësuesit nuk duhet ta shohin veten si palë të izoluar kur bëhet fjalë për radikalizimin në shkollën ose në mjedisin e tyre. Fëmijët dhe familjet nuk duhet të turpërohen ose të “demonizohen”; një opsion janë bisedat e anonimizuara me partnerët profesionistë.
- Përfshirja me fëmijët është e rëndësishme, por nuk duhet të teprohet! Fëmijët kalojnë më shumë kohë me mësuesit e klasës sesa me prindërit, dhe kjo është arsyeja pse mësuesit duhet të bëjnë këtë trajnim.
- Trajnimi ballë për ballë është më efikas se trajnimi virtual. Ndryshimi i qëndrimeve zakonisht nuk është i mundshëm në realitetin virtual.
- Të zhvillohet ndarja e vlerave, duke përfshirë një kulturë shëndeti dhe sigurie.
- Procesi i parandalimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm duhet të trajtohet si parandalimi i llojeve të tjera të joshjes/rekrutimit për pasoja të pasigurta/të pashëndetshme si p.sh. shfrytëzimi seksual i fëmijëve.
- Të përfshihen praktikat e reflektimit, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm.
- Të bihet dakord mbi një kod profesional etike.

Shembuj

- Shkolla dhe siguria: shikoni <https://www.schoolenveiligheid.nl/> (Holandë)
- Klikoni dhe kontrolloni (Austri).
- WRAP (Seminar për rritjen e sensibilizimit dhe për parandalimin, Mbretëria e Bashkuar).

4. Si t'i bëjmë shkollat mikro-kozmose të sigurt dhe demokratike të shoqërive?

Pse është me rëndësi kjo për shkollat?

Nxënësit mund të mësojnë të bëhen qytetarë demokratikë (aktivë) në një mjedis të sigurt. Ata mësohen rreth strukturës demokratike dhe familjarizohen me të. Nxënësve u tregohen mënyrat demokratike për të ndryshuar mjedisin e tyre. Mësuesi krijon një “ne”. Krijimi i një mikro-kozmosi të një shoqërie demokratike nuk është njësoj si krijimi i një mikro-kozmosi të një shoqërie të sigurt. Siguria lidhet me aftësitë pedagogjike të mësuesve, ndërsa demokracia lidhet me një mënyrë konfigurimi të shkollës.

Ne duhet të fokusohemi te nxitja e një rezistence demokratike. Vitaliteti demokratik varet nga qytetaria aktive dhe kapaciteti për ripërtëritje përballë sfidave; idetë radikale dhe mendimi kritik janë forcat kyçe të ripërtëritjes dhe përshtatjes. Pjesëmarrja aktive në debat nxit përshtatjen dhe ripërtëritjen e shoqërisë.

Cili është objektivi i këtij lloji trajnimi?

Ky lloj trajnimi përcakton objektivat e mëposhtme.

- I gjithë stafi i shkollave duhet të jetë i ndërgjegjshëm rreth vlerës së një shkolle demokratike në një shoqëri demokratike, dhe të ofrojë mjetet për të krijuar kushtet për një shkollë demokratike. Të kuptohen parimet bazë të demokracisë, si zyrtare ashtu edhe jozyrtare.
- Mësuesit dhe stafi tjetër pedagogjik duhet të jenë të ndërgjegjësuar rreth roleve të tyre të rëndësishme si pjesëtarë kyçë të një shkolle demokratike.
- Të njihen strategjitë dhe zgjidhjet praktike për të nxitur një kulturë demokratike dhe një politikë shkolle në klasë dhe në shkollë më gjerësisht.

Kush është audienca e synuar?

- Drejtorët e shkollave.
- I gjithë stafi pedagogjik.
- Prindërit dhe përfaqësuesit e nxënësve mund të marrin pjesë në një program të tillë trajnimi.

Mesazhet kyçe dhe rekomandimet

- Edukimi rreth demokracisë dhe qytetarisë kërkon më shumë “të bësh” sesa “të dish”. Është më e efektshme që një mësim të përjetohet sesa të tregohet.
- Përcakton karakterin e shkollës.
- Duhet të jetë fluid dhe subjekt i rinegociemeve.
- Duhet të reflektojë mbi dialogët dhe bisedat brenda vendit.
- Të kuptohet se demokracia do të thotë më shumë sesa thjesht të arrihet një shumicë votash.
- Të kuptohet se demokracia është konflikt i organizuar; nuk mund të ketë marrëveshje të plotë mes të gjitha palëve, mbi të gjitha temat, gjatë gjithë kohës.

5. Siguria fizike

Pse është me rëndësi kjo për shkollat?

Drejtorët, mësuesit dhe nxënësit duhet të jenë të përgatitur për një sulm (p.sh. një sulm me armë në shkollë), duke shpresuar në minimizimin e viktimave nga një ngjarje e tillë. Ky trajnim do t'u mësonte personelit dhe nxënësve për shembull se si të gjenin strehim në klasa.

Cili është objektivi i këtij lloji trajnimi?

Ky lloj trajnimi përcakton objektivat e mëposhtme:

- të kryhet vlerësimi i rrezikut i incidenteve;

- të kuptohen modelet e ndryshme për ndërhyrje: dhuna, evakuimi ose bllokimi;
- të mësojnë se çfarë duhet bërë në secilin rast dhe çfarë roli do të luajnë agjencitë e tjera;
- të mësojnë se si të gjejnë strehim nëpër klasa në rastin e një sulmi terrorist;
- të mësojnë se ku janë daljet e emergjencës;
- të mësojnë se çfarë duhet bërë nëse polarizimi rritet dhe kthehet në dhunë mes nxënësve;
- të mësojnë se si të largohen, të fshihen ose madje edhe të luftojnë.

Kush është audienca e synuar?

- Stafit kryesor të trajnohet në menaxhimin e rrezikut ndaj sigurisë fizike, të përmirësojë aftësitë ekzistuese dhe njohuritë e stafit me përgjegjësinë aktuale të shëndetit dhe sigurisë.
- I gjithë stafi të zhvillojë trajnim të rregullt për rritjen e sensibilizimit dhe vlerësimin e rrezikut dhe sesione praktike, të drejtuara nga personel i trajnuar.

Mesazhet kyçe dhe rekomandimet

- Të bihet dakord për protokollin lokal multi-agjenci, duke nisur diskutime me agjencitë përkatëse si policia, shërbimi i zjarrfikëses dhe autoritetet vendore.
- Vlerësimi i rrezikut është kyç.
- Protokollin duhet të marrin formën e një peme komunikimi, në mënyrë që detajet të mos mbahen vetëm në një vend i cili mund të mos jetë i aksesueshëm.
- Një pemë përgjegjësish që përcakton përgjegjësitë e gjithkujt.
- Përcaktimi i përgjegjësive praktike: pastrimi i korridoreve, komunikimi me shtypin, media sociale dhe prindërit.

Shembuj

- Parimet se si të qëndrojmë të sigurt: Vrapo, fshihu dhe trego (modeli aktual i Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar)

C. Aftësitë për t'u përballur me sfidat e sotme

6. Aftësitë në njohjen e medias sociale, lajmeve të rreme dhe teorive konspirative

Pse është me rëndësi kjo për shkollat?

Adoleshentët e ekspozuar së tepërmi ndaj teknologjisë (smartfonët dhe media sociale) njihen si të ashtuquajturit “screenagers”. Marrëdhëniet e tyre me personat e afërt dhe të tjerët shpesh lidhen në mënyrë të pandarë me përdorimin e telefonit. Telefonat gjithashtu u japin atyre një rrjedhë informacioni nga agjencitë zyrtare të lajmeve. Por, gjithnjë e më shumë, ato ofrojnë çdo lloj “faktesh alternative” të rishpërndara, thashetheme madje edhe lajme të rreme të ndërtuara në mënyrë profesionale dhe teori konspirative që kanë synimin të disinformojnë dhe të destabilizojnë shoqëritë dhe komunitetet.

Në të njëjtën kohë, kjo teknologji mund të shfrytëzohet në mënyrë pozitive, për fushata mes personave të afërt dhe forma të tjera përfshirjeje civile.

Cili është objektivi i këtij lloji trajnimi?

Për mësuesit, si ata didaktikë dhe pedagogjikë, duhet të aplikohen të njëjtat kompetenca për aftësitë në njohjen e medias sociale dhe informacionit. Ato janë marrë nga publikimi i UNESCO-s “Program mësimor për mësuesit për njohjen e medias dhe informacionit”⁵ (5) dhe janë si vijon:

- të kuptojnë rolin dhe funksionet e medias në shoqëritë demokratike;
- të kuptojnë kushtet nën të cilat media mund të kryejë funksionet e veta;
- të vlerësojnë në mënyrë kritike përmbajtjen e medias nën dritën e funksioneve të medias;
- të përfshihen me median për vetë-shprehje dhe pjesëmarrje demokratike;
- të kontrollojnë aftësitë (duke përfshirë teknologjitë e informacionit dhe komunikimeve (ICT-të)) që nevojiten për të krijuar përmbajtje të gjeneruar nga përdoruesi.

Kush është audienca e synuar?

- Mësuesit dhe menaxhimi i shkollës.

Mesazhet kyçe dhe rekomandimet

- Mund të ishte tërheqëse dhe frymëzuese që nxënësit t'u paraqisnin mësuesve botën virtuale, teknologjitë dhe platformat e tyre virtuale.
- Duke qenë se njohja e medias mund të integrohet dhe sinkronizohet me kompetencat jashtë realitetit virtual mbi qytetarinë, mendimin kritik dhe rolin e agjencive të lajmeve dhe medias, trajnimi duhet të ndërtohet mbi rolet e mësuesve dhe jo mbi botën e bukur të teknologjisë.

⁵ Shikoni <http://unesdoc.unesco.org/images/0019/001929/192971e.pdf> online.
(Wilson, C., Grizzle, A., Tuazon, R., Akyempong, K., & Cheung, C. K. (2013). *Program mësimor për mësuesit për njohjen e medias dhe informacionit*. UNESCO)

Shembuj

Shikoni publikimin e UNESCO-s “Program mësimor për mësuesit për njohjen e medias dhe informacionit” për shembuj dhe këshilla praktike.

7. Trajnimi depolarizues, tensionet në shoqëri, investimi në paqe dhe stabilitet social

Pse është me rëndësi kjo për shkollat?

Për të ndërtuar një urë mes subjekteve dhe për të mbështetur vlerat e përbashkëta. Për të menaxhuar konfliktet e identitetit dhe për të ndërtuar kohezionin. Për të pasur një dialog të sigurt dhe konstruktiv dhe për ta pajisur me argumente.

Cili është objektivi i këtij lloji trajnimi?

- T’u shpjegohet mësuesve rreziku i polarizimit dhe mekanizmat që nxisin dhe përshpejtojnë polarizimin.
- Të zhvillohen aftësi dhe një perspektivë për zgjidhjen e konflikteve: Si të menaxhohen emocionet dhe konflikti, cila është mënyra e sjelljes në këtë lloj situatë?
- Të krijohet një komunitet specialistësh dhe të promovohet mësimi nga personat e afërt.
- Të ndihmohen mësuesit të kuptojnë rolin e tyre si mësues dhe edukatorë.
- Të rritet ndërgjegjësimi se cilat lloje konfliktesh ekzistojnë dhe si të përdoret menaxhimi i konfliktit dhe të fokusohen te aftësitë.
- Të ndihmohen mësuesit të mësojnë se si të dëgjojnë dhe kuptojnë, dhe t’i mësojnë nxënësit të menaxhojnë ndjenjat e tyre.

Kush është audiencia e synuar?

Ka dy lloje audiencash të synuara për këtë lloj programi trajnimi.

Niveli një

- E gjithë shkolla.
- Komuniteti i shkollës: drejtuesit e shkollës, mësuesit, edukatorët, stafi mbështetës, grupet e interesit (punonjësit socialë).

Niveli dy

- Një ekip me vullnetarë që zhvillojnë ekspertizën.
- Shkolla nuk mund ta bëjë këtë vetëm, për shkak të tensioneve të shoqërisë dhe problemeve të shoqërisë. Nevojitet gjithashtu edhe inputi i shoqërisë për të zgjidhur polarizimin.

Mesazhet kyçe dhe rekomandimet

- Të forcohet dhe të fuqizohet komuniteti i arsimit.
- Të ofrohen mbështetje, aftësi dhe njohuri rreth (de)polarizimit.
- Të gjendet një pozicion i mesëm mes përbaljes së plotë me konfliktin dhe largimit prej tij.

- Shkollat duhet të dinë se kush janë partnerët/ekspertët në fusha të ndryshme.
- Trajnimi në aftësitë bazë do të mbështesë të gjithë komunitetin në shkollë.
- Trajnimi duhet të përfshijë metoda eksperimentale; ai nuk duhet të jetë vetëm një proces informues.
- Trajnimi duhet të përshtatet me kontekstin e secilës shkollë individuale.

Shembuj

- Trajnimi mbi menaxhimin e depolarizimit.

8. Trajtimi i kulturave, fesë, ideologjisë dhe identitetit

Pse është me rëndësi kjo për shkollat?

Shkolla është një mikro-kozmos i shoqërisë në të cilin zhvillohen debatet e mëdha rreth identitetit. Kulturat dhe fetë e ndryshme janë pjesë e rëndësishme e formimit të identitetit, që i përgjigjen pyetjes “Kush jam unë?” Diversiteti i nxënësve duhet të vlerësohet dhe identitetet duhet të jenë përfshirëse, jo përjashtuese. Kur nxënësit mendojnë se identiteti i tyre “po sulmohet”, kjo është një pikënisje e mirë për të punuar me ta. Shkollat mund të përpiqen të përballen me diferencat ose mund të kërkojnë ngjashmëri dhe të fokusohen në atë që kanë të përbashkët nxënësit. Ideologjia e barazisë duhet të jetë pjesë e karakterit të shkollës.

Cili është objektivi i këtij lloji trajnimi?

- Të rritet kapaciteti i mësuesve për të krijuar një mjedis në të cilin nxënësit mund të shprehin pikëpamjet e tyre dhe mund të ngrenë tema që kanë rëndësi për ta.
- Të trajtoni ndryshimet.
- Të rritet ndërgjegjësimi i temave të identitetit (përmes historive personale).
- Të ndihen të gjithë të përfshirë.
- Të nxitet aftësia e nxënësve për të bashkëpunuar.
- Disa mësues duhet të jenë të ndërgjegjshëm rreth ideologjive të pabarazive
- Mësuesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për anësitë, kompetencat dhe mandatet e tyre.
- Të mësohen bazat e identitetit dhe ideologjisë dhe si të integrohen këto në subjektin tuaj.

Kush është audiencia e synuar?

Përcaktohen dy grupe.

1. Të gjithë mësuesit duhet të mësojnë se si të krijojnë një kulturë përfshirjeje, dhe se si të mos i përkeqësojnë situatat.
2. Specialistët duhet të edukohen rreth identiteteve, ideologjive, si të moderojnë një debat kontrovers, si të administrojnë me këtë nocion mospërputhshmërie.

Mesazhet kyçe dhe rekomandimet

- Identiteti i shkollës mund të jetë në konflikt me identitetin e individit. Fokusi duhet të jetë mbi mënyrën se si funksionojnë bashkë identitetet.
- Identiteti i rrugës duhet të mbahet jashtë shkollës, dhe nxënësit duhet të ndihmohen të kuptojnë pse.
- Ne duhet të marrim në konsideratë se identiteti dominon kombësinë dhe/ose fenë “tjetër”.
- Fokusimi te identiteti i shkollës mund të ndihmojë në lehtësimin e preokupimeve të tepërta (dëmtuese) me identitetin kombëtar dhe fetar.
- Mësuesit që kanë frikë ose që nuk duan punë shtesë mund të binden sapo kjo të shpjegohet se është në interesin e tyre të parandalohen problemet e sjelljes siç është bullizmi ose mungesa e disiplinës (nëse ekzekutohet saktë, ky trajnim mund të ndihmojë me menaxhimin e sjelljeve të tjera).
- Pikënisja është te reflektimet e mësuesve rreth identitetit dhe paragjykimeve të tyre: idetë që ata kanë marrë nga mjediset e tyre, dhe mënyra se si kjo ndikon te puna e tyre. Kjo do të krijojë më shumë ndërgjegjësim.
- Përdorni metodat e pedagogjisë kulturore (si piktura, muzika dhe teatri) për të identifikuar dhe nxitur pikat e forta kulturore.
- Ndërgjegjësohuni se diskutimet mbi të drejtat e njeriut shpesh përqendrohen vetëm te aspektet fetare ose kombëtare: ky është një kuptim tepër i ngushtë dhe duhet të zgjerohet.
- Shfrytëzoni referencat e kulturës popullore (si lojtarët e futbollit ose këngëtarët).
- Shfrytëzoni leadershipin e nxënësve (jepuni nxënësve mundësi).
- Fokusohuni te bashkëveprimi nga poshtë-lart.

Shembuj

- Ndani praktikat më të mira, si në shembullin e mëposhtëm:
 - tregojini klasës fotografi të identiteteve të ndryshme;
 - çdo nxënës shkruan rreth identiteteve të ndryshme;
 - bëni fotografi të identiteteve nga komuniteti juaj;
 - përdorni metoda kulturore dhe ekspresive.
- “Dialog macht Schule”: multiplikatorët socialë me sfonde të ndryshme (Gjermani).
- Histori personale (metodat biografike).
- Krijoni një program shkëmbimi mes shkollave me nxënës me sfonde të ndryshme.

Rekomandime të përgjithshme

1. Minimumi për trajnim: nevojitet, këshillohet

Në përgjithësi, mësimi dhe reflektimi mbi karakterin dhe vlerat themelore të shkollës duhet të jetë një proces i vazhdueshëm. Pavarësisht kësaj, të gjitha shkollat duhet të marrin të paktën pak trajnim në parandalimin e radikalizimit.

Ky trajnim duhet të ketë elementet e mëposhtme.

1. Përgatitja e mirë

- Pritshmëri të qarta, të ndara paraprakisht me pjesëmarrësit.
- Puna përgatitore duhet të jetë gati paraprakisht për të gjithë pjesëmarrësit. Për shembull, kini gati një pyetje ose një studim rasti në mendje, ose lexoni këtë dokument.
- Caktoni barrierat të ulëta për pjesëmarrjen. Sesioni i trajnimit duhet të jetë maksimumi 2 orë si fillim. Pasi është nxitur interesi, sesioni vijues i trajnimit mund të jetë më i gjatë.
- Sigurohuni që menaxhimi/drejtuesit e shkollës ta mbështesin trajnimin.

2. Vendosja ballë për ballë me trajnim me ekspertë

- Trajnimi ballë për ballë gjeneron një kuptim të përbashkët dhe krijon vend për biseda.
- Përdorni një trajnues ekspert që është i besueshëm dhe mund të ndajë shembuj nga jeta reale.

3. Fokusohuni vetëm te parandalimi i radikalizimit

- Fokusohuni vetëm te parandalimi i radikalizimit dhe roli i mësuesit në këtë: “Cili është subjekti, cilat janë shenjat dhe çfarë mund të bëj për këtë?”
- Ofroni njohuri, aftësi dhe reflektim.

4. Praktik

- Ofroni mjete praktike dhe shpërndani materiale.

5. I përshtatur

- Kujdesuni për problemet, nivelin e njohurive dhe nivelin e rrezikut në shkollë.

6. Mesazhi: “Është e realizueshme”

- Mesazhi i trajnimit duhet të jetë: “Kjo është e realizueshme për ju: si mësues, ju plotësoni kërkesat — nuk duhet të jeni ekspert mbi radikalizimin për ta bërë këtë.”
- Krijoni një sens komuniteti, bëjeni të qartë se sfidat nuk mund të zgjidhen nga një person i vetëm, bëjini pjesëmarrësit të ndihen të mbështetur.

2. Faktorët për krijimin e programeve të trajnimit

Në takimin në Helsinki, u përmendën shumë faktorë dhe u dhanë rekomandime.

Megjithëse shumica e tyre është përfshirë tashmë në kapitullin e mëparshëm, më poshtë janë listuar disa prej shënimeve më të përgjithshme.

- Vendosni se cilat janë prioritetet tuaja.
- Diskutoni paraprakisht kohën që keni në dispozicion.
- Balanconi llojet e ndryshme të ekstremizmit.
- Përdorni shembuj nga jeta reale, duke qenë se janë më të besueshëm.
- Trajnuesit duhet të jenë ekspertë për të qenë të besueshëm.
- Mësuesit mund të përfshihen në krijimin e programeve: për shembull mund të paraqesin situatat sfiduese me të cilat përballen ose shkaqet për të cilat shqetësohen.
- Duhet të përgatitet transferimi i punës së përditshme. Duhet të jetë praktike që mësuesi të jetë në gjendje ta përdorë trajnimin.
- Kërkojuni ofruesve të programeve të tjera të trajnimit se si t'i operacionalizojnë ata objektivat e trajnimit dhe se si e vlerësojnë se deri në çfarë shkalle janë arritur objektivat.
- Trajnimi duhet të bëhet tërheqës, për të inkurajuar pjesëmarrjen: programet interaktive me role që bëhen individualisht ose në grupe të vogla janë shumë më efikase.
- Qëndrimet nuk mund të diskutohen në formë leksioni. Duhet të ofrohen ushtrime që njerëzit të kuptojnë anësitë, bindjet dhe qëndrimet e tyre.
- Nëse trajnimi synon që të fitohen aftësi të reja, këto aftësi duhet të praktikohen, qoftë brenda grupit ose me një aktor.
- Mësuesit duhet të përfshihen në krijimin e programeve të trajnimit. Trajnimi fillestar i mësuesve mund të përgatitet me përfshirjen e vetë mësuesve, dhe të fillojë me sfidat me të cilat përballen ata.
- Duhet marrë në konsideratë nëse trajnimi është vullnetar ose i detyrueshëm: në të dyja rastet ka faktorë pro dhe kundër.
- Përvoja tregon se trajnimi vullnetar ka efektin më të qëndrueshëm.
- Filloni me një program ngacmues: një program i shkurtër ngacmues një orë me ushtrime të mira që mund të krijojë lidhjen e individëve me emocionet e tyre, gjë që e bën më të lehtë vijimin me më shumë trajnim.
- Trajnimi i përzierë: nëse individët marrin pjesë si ekip (p.sh. mësuesi, drejtori i shkollës dhe një prind), ata kanë lidhë autoritativ për të sjellë ndryshim.–



Translated within:

